



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Prill, 2019

Edhe gazetarët e huaj duan t shkruajnë për SBASHK-un

Në prag të zgjedhjeve të reja në Parlamentin e Evropës



Respekt për angazhimet dhe arritjet nëpër vite
Në selinë e SBASHK-ut
kishim një vizitë ... (faqe 6)

Mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë protestuan në Bruksel

Për të shpalosur publikisht kërkesat e qarta të miliona punëtorëve të arsimit dhe sektorëve tjerë nga e tërë Evropa Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës ka organizuar protesë masive në Bruksel me moton “ETUCE formëson të ardhmen e Evropës me mësuesin”. Mes mijëra protestuesve ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut për të cilët është bërë një pritje e veçantë nga drejtorja e ... (faqe 4)



Intervistë me mësimdhënësin e veprimtarin Xhavit Qorrolli

Nuk është e vështirë, por është e shenjtë ... (faqe 3)

Kur disa drejtorë të DKA-ve duan t'i hynë në hatër Ministrit



Harrojnë se koha e kërcënimeve ka ikur

U munduan ta godasin SBASHK-un edhe në seancën e jashtëzakonshme parlamentare me ofendime e gënjeshtër dhe arritën efek ... (faqe 5)

Shtohen kërkesat për 5 trajnimet e SBASHK-ut



Pushimin e vikendeve e kthejnë në angazhim për dije të reja

Është thënë nga MASHT se pas monitorimit fillestar në orët mësimore të një numër i caktuar mësimdhënësish nga ana e inspektorëve... (faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Zëri protestues i mësuesit në Evropë



Në Kosovë e kudo në shtetet e botës janë shtuar shumë sfidat në sektorin e arsimit. Mësimdhënësit kërkojnë zëshëm që të përmirësohen kushtet e punës në shkolla, që të ndalen tendencat e privatizimit të sistemit arsimor, që të ngrihen pagat, që të shtohen investimet në sektorin e arsimit për ta bërë shkollën ambient pune e kreativiteti, që të forcohet dialogu social, që sindikata të jenë të përfshira në vendimmarrje dhe që të nxitet qytetaria dhe guximi qytetar.

Gjithë këto dhe sfidat të tjera të shumta kanë bërë që ETUCE të organizojë bashkë me Konfederatën e

Sindikatave të Evropës një protestë në Bruksel. Kjo protestë e mbajtur më 26 prill ka bërë bashkë mijëra punëtorë nga sektorë të ndryshëm. Mes tyre kishte shumë protestues nga sektori i arsimit nga Belgjika, Franca, Italia dhe vende të tjera. Zërit protestues të mësuesit në Evropë iu bashkua edhe ai i SBASHK-ut.

Përfaqësuesve të SBASHK-ut iu bë një pritje e veçantë dhe ata janë vënë në ballë të protestës bashkë me drejtoreshën e përgjithshme të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës. Protestuesit kanë marshuar nëpër rrugët e sheshet e Brukselit për t'u ndalur para ndërtesës së BE-së. Folësit kanë shprehur kritikën e tyre në mes të miliona punëtorëve duke kërkuar që e ardhmja e Evropës të formësohet me mësuesin si faktor kyç.

Kjo protestë ishte shprehje dhe dëshmi e solidaritetit mes sindikatave të arsimit në Evropë dhe botë dhe zëri i fuqishëm i tyre.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësin e veprimtarin Xhavit Qorrolli

Nuk është e vështirë, por është e shenjtë puna e mësuesit



Xhaviti është mësimdhënës i lëndës edukata qytetare. Ai është veprimtar dhe njeri i dëshmuar në aktivitete. Me Klubin e Gjelbër krijon ambient të pastër, por edhe me riciklimin e plastikës krijon mjete modeste për të ndihmuar familjet që kanë

nevojë. “Profesioni i mësimdhënësit është i shenjtë, por puna e mësimdhënësit nuk është e vështirë për ata që duan të punojnë me përkushtim. Jo rastësisht mësuesi mbetet mësues gjatë gjithë jetës”, shprehet Xhaviti në intervistën për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Xhavit Qorrolli?

Xhaviti:

Xhavit Qorrolli është i lindur me 24.04.1958 në fshatin Rashincë, Komuna e Shtimes. Ka të kryer Fakultetin Filozofik dega Filozofi-Sociologji. Aktualisht është mësimdhënës i lëndës Edukatë Qytetare në shkollën e mesme të ulët “Emin Duraku” në Shtime. Ka ndihmuar procesin arsimor gjatë viteve të 90-ta në çdo aspekt. Është pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1981, pjesëmarrës i protestave të viteve të 90-ta, ka përkrahur dhe ka ndihmuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Është i martuar dhe ka një vajzë.

Që nga shtatori i vitit 2000 punon si mësimdhënës i lëndës së Edukatës Qytetare dhe gjatë këtyre 19 viteve ka kontribuar shumë në ngritjen e cilësisë në shkollën tonë si dhe është marrë me shumë aktivitete jashtë kurrikulare si: organizimin e Sofrës shkollore për 8 vite, aktivitete kulturore dhe sportive, vizita nëpër institucione të komunës së Shtimes, është themelues i Klubit të Gjelbër i cili merret me riciklimin e plastikës dhe mjetet që sigurohen ndihmohen familjet e varfra në komunën e Shtimes dhe angazhohen që të kemi një ambient sa më të pastër dhe të gjelbëruar në shkollë dhe rreth saj.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot?

Xhaviti:

Profesioni i mësimdhënësit është i shenjtë, por puna e mësimdhënësit nuk është e vështirë për ata që duan të punojnë me përkushtim. Jo rastësisht mësuesi mbetet mësues gjatë gjithë jetës. Nëse ti duhet t’i edukosh nxënësit, ti duhet të jesh i edukuar. Nëse ti dëshiron që nxënësit e tu të dalin të suksesshëm, ti duhet të jesh i përgatitur moralisht dhe profesionalisht, thjesht ti duhet të jesh idol i tyre. Profesioni i mësimdhënësit sot është shumë i vështirë. Derisa ky profesion çmohet në gjithë botën, tek ne mësimdhënësi ka filluar të nëpërkëmbet edhe pse ai ende qëndron i fortë sepse ai është i përgatitur, ai e din ku e ka vendin e punës dhe çka punon. Mësimdhënësi sot e ka shumë të vështirë të punoj sepse në shkolla nuk ka mjete për punë. Në shkolla investohet shumë pak e mos te themi fare. Pavarësisht prej asaj, mësimdhënësit prapë e ushtrojnë detyrën e tyre me dinjitet. Shoqëria që nuk e ka prioritet arsimin kurrë nuk do të jetë shoqëri e kompletuar. Shpresojmë se në të ardhmen, shteti do t’i jep prioritet arsimit.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Xhaviti:

SBASHK ka aktivitete të shumta. Do ti veçoja trajnimet e mësimdhënësve nga ana e SBASHK-ut. Pas shumë përpjekjeve kemi Ligjin për Statusin e Punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta, Kontratën kolektive, që nuk po zbatohet mjaftueshëm, mirëpo me angazhim më të madh të SBASHK shpresojmë të zbatohet në tërësi. Kjo është një mirënjohje e madhe për ata pishtarë të arsimit. Mendoj se keni dhënë një kontribut të rëndësishëm në organizimin e grevave, duke i mbrojtur me përkushtim të drejtat e mësimdhënësve.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?

Xhaviti:

Insistoni që pagat jubilarë të mësimdhënësve të mos shkojnë përmes gjykatës siç po ndodh , por t'u jepen punëtorëve posa të dalin në pension.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga të arriturat në Komunën e Shtimes?

Xhaviti:

Komuna e Shtimes prinë për të mirë sa i përket sferës së arsimit. Një komunë e dalë nga lufta, krejtësisht e shkatërruar, ka arritur që ta rregullojë infrastrukturën shkollore gati në të gjitha fshatrat. Arsimi është prioritet i vazhdueshëm. Me gjithë vështirësitë ka arritur që ta zbatoj me përpikëri Kurrikulën Bërthamë dhe Kurrikulën e Re. Vlen të ceket se Shtimja mbanë çdo vit Konferencën për Arsim. Gjithashtu mbahet edhe shkolla verore ku nxënësit shprehin shkathtësitë

e tyre përmes aktiviteteve të ndryshme, garat komunale të cilat organizohen çdo vit nëpër lëndë të caktuara, shkollat e komunës tonë janë të pajisura mjaftueshëm me mjete të teknologjisë të cilat përdoren nga nxënësit dhe mësimdhënësit në procesin edukativo-arsimor.

Arsimimi sot:

Çka ju sugjeroni mësimdhënësve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?

Xhaviti:

Që të anëtarësohen sa më shumë në SBASHK , të jenë pjesë e proceseve sepse vetëm në këtë mënyrë do të mund të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të tyre

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Xhaviti:

Ju sugjeroj kolegëve që brenda shkollës të merren me aktivitete të lira ku nxënësit do të kenë mundësi të shprehin kreativitetin e tyre në fusha të ndryshme si sport, kulturë, art etj.

Gjatë muajit

Në prag të zgjedhjeve të reja në Parlamentin e Evropës

Mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë protestuan në Bruksel



Për të shpalosur publikisht kërkesat e qarta të miliona punëtorëve të arsimit dhe sektorëve tjerë nga e tërë Evropa Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës ka organizuar protestë masive në Bruksel me moton “ETUCE formëson të ardhmen e Evropës me

mësuesin”. Mes mijëra protestuesve ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut për të cilët është bërë një pritje e veçantë nga drejtorja e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës , znj. Suzan Flocken. Të premtën e 26 prillit Brukseli ka jehuar nga zërat e mijëra protestuesve që po flisin guximshëm në mes të miliona të punësuarve në arsim e kudo në sektorët tjerë. Ata u janë drejtuar para ndërtesës së Parlamentit të Evropës Parlamentarëve të tanishëm dhe të atyre që do të zgjidhen në maj me kërkesat që mësuesi të ketë shumë më tepër mbështetje dhe që me të të formësohet e ardhmja e kontinentit të vjetër.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut fillimisht kanë vizituar selinë e Unionit të sindikatave të Evropës dhe atyre ju ka dëshiruar mirëseardhje drejtoresha e përgjithshme znj.Susan Flocken. Në shenjë respekti

për arritjet sindikale dhe për ardhjen për të marrë pjesë në këtë demonstratë të madhe, përfaqësuesit e SBASHK-ut janë nderuar duke i vënë në rreshtin e parë të protestës. Ata pjesëmarrjen në këtë protestë e kanë dëshmuar edhe me flamurin e SBASHK-ut i cili ka vluar në Bruksel në mes dhjetëra flamujve të sindikatave tjera. Protestuesit kanë marshuar nëpër sheshet kryesore të Brukselit e duke brohoritur zëshëm në mbrojtje të profesionit dhe figurës së mësuesit e pastaj janë ndaluar para ndërtesës së Komisionit Evropian për të drejtuar kritikën dhe kërkesat e tyre ndaj Parlamentit të Evropës dhe Qeverive të shteteve nga kanë ardhur këto sindikata.



Me interesim të veçantë e me brohoritje mbështetjeje e me duartrokime të gjata është përcjellë fjala e drejtores së përgjithshme të Unionit të Sindikatave të



Arsimit të Evropës, znj. Suzan Flocken në fjalën e saj ajo ka përmendur katër kërkesat kyçe drejtuar parlamentit dhe institucioneve të shteteve të Evropës duke kërkuar që të shtohet buxheti për arsimin, të forcohet dialogu

social dhe që sindikatat e arsimit të jenë gjithmonë të pranishme në vendimmarrje. Pas protestës, drejtoresha e përgjithshme znj Flocken ka takuar delegacionin e SBASHK-ut duke shprehur respektin e saj të lartë për punën që po bëjnë kjo sindikatë e për ta përsëritur edhe njëherë se SBASHK-u gjithmonë do ta ketë mbështetjen e 11 milion mësimitdhënësve të Evropës që janë në komitet të sindikatave të arsimit të Evropës (ETUCE).

Znj. Flocken i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së delegacionit të SBASHK-ut duke pohuar se do ta vizitojë së shpejti Kosovën bashkë me kryetaren e ETUCE-s znj. Christine Blower.

Kur disa drejtorë të DKA-ve duan t'i hynë në hatër Ministrin Harrojnë se koha e kërcënimeve ka ikur



U munduan ta godasin SBASHK-un edhe në seancën e jashtëzakonshme parlamentare me ofendime e

gënjeshtra dhe arritën efekt të kundërt. U munduan edhe në një takim në MASHT me drejtorët e DKA-ve, KMLDNJ-në deklarime të pabazuara e me ngjyra kërcënimi ta ndryshojnë zërin e mësimitdhënësve të Kosovës, por kot. Këshilli Drejtues i SBASHK-ut dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve duke bartur zërin e mësimitdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të arsimit e kanë thënë qartë se nëse Parlamenti voton për të bërë barazimin e koeficienteve të mësuesve të nivelit 1-5, të pedagogëve, psikologëve e sekretarëve të shkollave me kolegët e tyre të nivelit 6-9, atëherë në shenjë të solidarizimit me ta do të zgjatet ky vit shkollor për një javë e nëse kjo nuk ndodh atëherë nuk do të ketë kompensim të as edhe një ore të humbur në grevë.

Për grevën dhe për qëndresën ndaj presioneve pas grevës është njoftuar edhe opinionimi vendor dhe ndërkombëtar. SBASHK-u ka marrë përgjegjësi të lëvdata nga kolegët e tyre kudo në Ballkan dhe nga udhëheqësit më të lartë të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës me 11 milionë anëtarë për punën, angazhimet, arritjet dhe organizimin e mirë sindikal.

Mirëpo disa drejtorë të DKA-ve u munduan t'i hynë në hatër Ministrin Bytyqi dhe nisen me kritika pa as edhe një argument. Nga më të zëshmit në kritikën e pabazuara e të paargumentuara ndaj SBASHK-ut ka nisur të dalë drejtori i DKA-së në Kastriot (Obiliq) Agim Spahiu. Ai madje ka bërë edhe një "zbulim" lidhur me grevën duke u deklaruar publikisht se gjoja ajo paska qenë jo ligjore ngase SBASHK nuk e ka pyetur atë se kur të nis me grevën dhe për këtë ky Agimi kudo ndodhet po krekoset se do të ngrit kallëzim penal ndaj kryetarit të SBASHK lidhur me grevën.

SBASHK-u për të satën herë këshillon drejtorët e DKA-ve dhe drejtorët e shkollave që mos të përdorin presione për kompensimin e orëve të humbura në grevë. Ata duhet të lexojnë pak më shumë dhe do të kuptojnë se greva është e ligjshme dhe ka pasur përkrahjen edhe të gjithë sindikatave të Ballkanit e Evropës dhe se ligji nuk obligon grevistët të kompensojnë orët e humbura në grevë.

Edhe gazetarët e huaj duan të shkruajnë për SBASHK-un

Respekt për angazhimet dhe arritjet nëpër vite



Në selinë e SBASHK-ut kishim një vizitë të veçantë. Udhëheqësi i GIZ-it gjerman z. Boris Scharlovski bashkë me zyrtaren Alberta Alihajdari kanë shoqëruar në një vizitë në SBASHK gazetarin gjerman Norbert Glaser, i cili njëherë është edhe konsultat për medie i akredituar nga ana e GIZ-it.

Në një atmosferë miqësore e në një bisedë të lirë udhëheqësi i GIZ-it gjerman z. Boris Scharlovski ka

Ata duhet të kuptojnë se mësimdhënësit e kanë thënë fjalën e tyre për këtë dhe tentimi që të dërgohen në orë me shantazhe, shpifje dhe deklarata plot gënjeshtër është presion dhe shkelje e të drejtës së tyre elementare. Le të lexojnë pak më shumë këta drejtorët që duan t'i hynë në hatër Ministrin dhe do të shohin se Kontrata Kolektive e Arsimit e saktëson se punëtorët e arsimit kanë javë 5 ditësh të punës dhe 20 orë mësimore në javë.

Çdo ngarkesë mbi këtë mund të bëhet me pajtimin mes dy palëve. Të kërkohet të punohet të shtunave, pa pajtimin e punëtorëve të arsimit është shkelje e Kontratës Kolektive, e Kontratës individuale të punës dhe e Ligjit. Ata kërkuan të punohet edhe në ditët e pushimeve shtetërore, por kjo është shkelje edhe më e rëndë e ligjeve.

Këta disa drejtorë të DKA-ve mos të harrojnë se janë emëruar nga kryetarët e komunave të tyre dhe kanë detyrë parësore të kujdesen për kushte më të mira të punës në institucionet arsimore në qytetet e tyre, kushte këto që janë shumë të vështira dhe përcillen me mungesa edhe të mjeteve elementare për punë, me vonesa të shumta gjatë renovimit të shkollave, me vonesa të sigurimit të lëndës djegëse, me kushte tepër të rënda në lokale përcjellëse dhe në nyjat sanitare dhe me shumë të tjera. Këto janë punën e angazhimet e tyre e besa edhe Ministri ka mjaft punë që duhet bërë.

treguar për arsyen e kësaj vizite. Ai pastaj ka treguar se tani e sa vite organizata që ai drejton ka bashkëpunim të frytshëm me SBASHK-un e në shërbim të arsimit edhe më të mirë në Kosovë. Ai pastaj ka prezantuar gazetarin gjerman Norbert Glaser për të treguar përvojën e tij të gjatë prej gazetari. "Z. Glaser ka shkruar shumë artikuj për sindikatat dhe kësaj radhe është angazhuar pikërisht nga Sindikata e Bashkuar e Mësimdhënësve të Gjermanisë që gjatë vizitës në Kosovë të përgatis artikuj për sistemin arsimor e në veçanti për aktivitetet, sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut", ka treguar z. Scharlovski.

Gazetari gjerman Glaser me bashkëshorten e tij, që është veprimtare sindikale në Gjermani, janë falënderuar për mikpritjen dhe kanë treguar se duan të

shkruajnë për arsimin në Kosovë e me theks të veçantë për historikun dhe angazhimet aktuale të SBASHK-ut.



Kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur mysafirët dhe pastaj i është përgjigjur shumë pyetjeve të gazetarit Glaser lidhur me historikun e SBASHK-ut, angazhimet në kohët e okupimit dhe sfidat, arritjet dhe angazhimet në gjithë vitet e pasluftës.

Kryetari Jasharaj duke dhënë këtë intervistë ka kujtuar kohët e vështira të okupimit dhe ka lavdëruar

miqtë ndërkombëtarë e veçmas sindikatën gjermane të arsimit, atë të Holandës dhe mikun e madh Valter, Sllovenisë dhe mikun e madh Shtrukelj dhe udhëheqësit sindikal të Internacionales Botërore të Arsimit, e veçmas sekretarin e përgjithshëm Fred Lieven të cilët ishin vazhdimisht pranë SBASHK-ut në kohët e vështira duke e ndihmuar dhe duke i dhënë mundësi që të tregojë realitetin e vështirë në arsimin e Kosovës në vitet e 90-ta. Kryetari Jasharaj ka treguar edhe për përkrahjen e miqve ndërkombëtar se edhe në vitet e para të pasluftës . në një pjesë të kësaj interviste kryetari Jasharaj është ndalur edhe te vizita studimore në Gjermani, që u mundësua falë mbështetjes së GiZ dhe zonjes Dagmar, që ishte udhëheqëse e GIZ atëherë duke shpalosur kujtime për takimet e shumta dhe përkrahjen e mikpritjen që kanë hasur kudo në Gjermani nga kolegët e sindikatës GEV.

Shtohen kërkesat për 5 trajnimet e SBASHK-ut Pushimin e vikendeve e kthejnë në angazhim për dije të reja



Është thënë nga MASHT se pas monitorimit fillestar në orët mësimore të një numër i caktuar mësimdhënësish nga ana e inspektorëve arsimor, do të fillohet në të ardhmen edhe me gradimin e punëtorëve në Arsimin Parauniversitar.

Me qëllim që t'ju ndihmojë anëtarëve të vet që të arrijnë më lehtë plotësimin e kushtit për gradim për numrin e caktuar të orëve të trajnimeve në programet themelore e ato plotësuese SBASHK-u ka zhvilluar përgatitje shtesë për realizimin e 5 trajnimeve të licencuara. Kështu përveç trajnimeve të organizuara



me sukses tani e sa kohë "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" dhe "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", trajnime këto plotësuese, është nisur edhe me organizimin gradual të trajnimeve themelore " Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" dhe "Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik".



Këto trajnime janë duke u zhvilluar në Prishtinë, Podujeve, Suharekë . Pejë, Viti , Deçan dhe në qytetet të tjera dhe sa vjen e shtohen kërkesat në këto dhe gjithë komunat e Kosovës për këto trajnime.



Trajnerët Hysen Sogojeva, Alban Zeneli, Blendor Shatri, Ramadan Gashi, Leonora Lokaj, Besim Haliti , Besa Krasniqi, Safet Beqiri dhe Atdhe Hykolli janë duke bërë gjithë të mundurën që trajnimet të arrijnë efektin e tyre dhe për këtë kanë marrë lëvdata të shumta nga pjesëmarrësit e këtyre aktiviteteve.

Urime pensionin koleg i nderuar z. Elez Krasniqi Edhe i pensionuar do të kontribuosh në SBASHK



Duke qenë gjithmonë në nivel të detyrës e si një sindikalist i vyer Elez Krasniqi një ditë pa dalë në pension ka ftuar anëtarët e Kuvendit të SAF e SAM për komunë n e Malishevës për të zgjedhur pasardhësin e tij në pozitën e kryetarit të sindikalistëve të arsimit në këtë komunë.

Puna dhe përkushtimi i SBASHK-ut në nivel qendror dhe arrijtet e shumta kanë bërë që edhe në këtë komunë të shtohet dukshëm numri i anëtarëve në sindikatën tonë. Edhe gara për të parin e sindikatës këtu ishte e fortë dhe pas tri radhëve të votimit u zgjodh në mënyrë demokratike kryetar Skënder Gashi, i cili është zotuar se do të vazhdojë me punën e përkushtuar dhe i ka bërë ftesë Elezit që edhe në të ardhmen ta ndihmojë me përvojën e tij.

Kryetarët e niveleve komunale nga të gjitha komunat e Kosovës dhe ai i Universiteteve bashkë me kryesinë e SBASHK-ut i kanë dërguar mesazhe Elezit duke i shprehur respekt për punën e angazhimet e më shumë se kjo e kanë uruar për pensionin duke e falënderuar për korrektësinë dhe respektin që ai ka treguar gjatë gjithë këtyre viteve sa ishte i pari i sindikatës në Malishevë.

Elezi po pensionohet , por ai mbetet pjesë e SBASHK-ut. Elezi e di moton tonë Bashkë e në SBASHK.

Llogaria e Pagës

Veç

- ✓ Mirëmbajtja e llogarisë
- ✓ Mobile Banking & E-Banking
- ✓ Njoftim nga BKT Mobile
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Kreditit
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Debitit
- ✓ Tërheqje në ATM të BKT-së Kosovë & Shqipëri
- ✓ Blerje në POS dhe Online

Pa komision shtesë!

BKT

Ne jemi gjithmonë këtu!

SBASHK në bashkëpunim me BKT ka arritur marrëveshje për të ju ofruar kredi me 0% shpenzime administrative, si dhe llogari page me 50 cent/muaj.